



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 847/13 Prot.

Tiranë, më 17. 12. 2025

V E N D I M

Nr. 298, Datë 17. 12. 2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 138 Regj., datë 05.06.2025, paraqitur nga z. A. H¹, kundër Shkollës 9-vjeçare “4 Dëshmorët”, Tiranë, në të cilën pretendohet për diskriminimin e djalit të tij, A. H, për shkak të “aftësisë së kufizuar²”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues, ndër të tjera, informon se:

“Jam prind i fëmijës A. H, nxënës i klasës 7A, të shkollës 9-vjeçare “4 Dëshmorët”, Tiranë. Djali ka pasur problematika që në parashkollor, ku dhe mësuesja ankohej për situatën e djalit. Djali është me aftësi ndryshe, me autizëm inflatik.

Në klasë të parë ka hasur problematika, duke i ndërruar klasën nga drejtoresha aktuale, për të cilën gjeta zgjidhje duke iu drejtuar Ministrisë së Arsimit. Që në klasën e parë deri në klasën e shtatë që është sot, i janë ndërruar 6 mësuese ndihmëse, edhe pse pas shumë kërkesave të mia dhe përpjekjeve, situata nuk ndryshonte.

¹ Në cilësinë e prindit të fëmijës A. H.

² Referuar dokumentit mjekësor është diagnostikuar me “Çrregullim të spektrit autik”.

Komunikimet e vazhdueshme me drejtoreshën e shkollës dhe institucionet arsimore, i kam me shkresa, në të cilat kam kërkuar që mos ti ndërrohej mësuesja fëmijës tim me aftësi ndryshe, sepse ndërrimi i mësueses i ka sjellë fëmijës shumë problematika në mësimdhënie. Përpos ndërrimit të mësueses i kam kërkuar MAS dhe shkollës përkatëse, që Shkolla duhet të ketë një punojës sigurie, sepse ndihem i pasigurt kur shkolla është e pambrojtur dhe roli i psikologes nuk është i mjaftueshëm për zgjidhjen e situatës së djalit dhe izolimit të problematikave të tij.

Fëmija refuzon të shkojë në shkollë, që në muajin shkurt 2025, për shkak të situatave në klasë, ku mësuesja ndihmëse aktuale, plus mësuesen kujdestare, nuk menaxhojnë rastin me A.

A, është dhunuar nga shoku i klasës dhe mësuesja ndihmëse aktuale dhe kujdestarja, nuk vendosën në dijeni drejtoreshën. A, e bullizojnë vazhdimisht, dhe për këtë gjë kam vendosur në dijeni dhe strukturat përkatëse. Mjeku i familjes ka nxjerrë rekomandim mbi situatën dhe kërkon vlerësim psiko-social të fëmijës.”

Subjekti ankues, në kërkesën fillestare ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit të fëmijës, A. H dhe ndërrimin e mësueses ndihmëse dhe psikologes. Nëpërmjet shkresës datë 26.06.2025³, parashtron se: *“Nuk kërkoj ndërrimin e mësueses ndihmëse dhe psikologes së Shkollës por, të shikohen problematikat, pasi këto i izolojnë dhe nuk i japin zgjidhje, pasi ndoshta mund të kenë ngarkesë politike (mendoj unë si prind)”*

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 5, i ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikon ndalimin e diskriminimit për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji. Sipas këtij neni ndalohet gjithashtu mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, të një ankimi ose procedure, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje, që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një

³ Protokolluar me Tonën me nr. 847/4 prot., datë 26.06.2025.

trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që lidhen me kërkimin e subjektit ankues pranë KMD-së, brenda afateve kohore ligjore, si dhe që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të shkresës me nr. 847/2 prot., datë 16.06.2025, ka kërkuar nga Shkolla, MAS, DRAP Tiranë, ZVA Tiranë dhe AKAP, informacionin dhe dokumentacionin si vijon:
 - “Argumentimin Tuaj, lidhur me pretendimet e palës ankuese.
 - Kopje të dosjes të dokumentacionit të nxënësit A. H.
 - Informacion lidhur me frekuentimin e procesit mësimor nga ana e nxënësit A. H. Masat e ndërmarra nga ana juaj lidhur me mbarëvajtjen e frekuentimit të shkollës nga ky nxënës.
 - Vendimin e Komisionit Multidisiplinar për nxënësin A. H, në të cilin janë përcaktuar nevojat arsimore të këtij nxënësi, rekomandimet për planin mësimor dhe programet lëndore, mjetet ndihmëse që i nevojiten nxënësit për të realizuar procesin mësimor-edukativ.
 - Cili ka qenë qëndrimi i Komisionit të ZVAP Tiranë, në lidhje me ecurinë e këtij nxënësi dhe veprimet e ndërmara nga ZVAP Tiranë, konstatimet mbi ecurinë e këtij nxënësi? Të vihet në dispozicion dosja e plotë e nxënësit.
 - Rekomandimet dhe udhëzimet që Komisioni i IA i ka dhënë mësuesve për hartimin e PEI-ve para se ti miratojë ato dhe ndihmesa që i ka dhënë mësuesve gjatë zbatimit të PEI-ve.
 - Konstatimet e Komisionit të IA për ecurinë e nxënësit me aftësi të kufizuar A. H, gjatë vitit mësimor 2024-2025.
 - Raportet e ecurisë së nxënësit me AK që i ka përcjellë ZVAP Tiranë.
 - Informacion lidhur me caktimin e mësuesve ndihmës për nxënësin A. H nga klasa e parë deri në klasën e shtatë.
 - Informacion nëse prindi është ankuar për mospërshtatje të fëmijës me mësuesin ndihmës dhe masat e ndërmarra nga ana juaj. Po ashtu edhe përsa i takon psikologes së Shkollës. Kopje të akt vlerësimeve të kësaj të fundit lidhur me ecurinë dhe përshtatjen e fëmijës në Shkollë.
 - Informacion dhe parashtrime lidhur me kërkesën e prindit për caktimin e një punonjësi sigurie në Shkollë.

- Si dhe, çdo informacion dhe dokumentacion që ju vlerësoni se ndihmon në sqarimin e problematikës në fjalë.”

2. Nëpërmjet shkresës me nr. 99 prot., datë 26.06.2025, Shkolla ka dërguar parashtrimet, duke shpjeguar ndër të tjera se:

“Në fillim të vitit shkollor 2024-2025, prindi refuzoi ta sillte fëmijën në Shkollë, në ditën e parë për shkak të pakënaqësisë ndaj mësueses ndihmëse që kishte asistuar fëmijën vitin e kaluar. Kishte pretendime që nuk është nënë me fëmijë dhe nuk e ndihmon djalë në përmbushjen e aspektit akademik.

Për të mos shkëputur fëmijën nga procesi mësimor, Drejtoria e Shkollës, në bashkëpunim me Shërbimin Psiko-Social, ofroi si alternativë përkohësisht asistencën nga Punonjësja Sociale, edhe pse në dispozicion kishte dy mësuese ndihmëse, propozim që u refuzua kategorikisht nga prindi.

Fëmija u rikthye në Shkollë vetëm me datë 16 tetor 2024, kur u caktua një mësuese e re ndihmëse, por edhe në këtë rast, u shprehën pakënaqësi të tjera nga ana e prindit, të cilat iu përcollën Shërbimit Psiko-Social dhe Drejtueses së Shkollës. Pretendimet ishin të tilla se pse ishte nënë me fëmijë të vogël dhe nuk e ndihmon në procesin mësimor.

Pavarësisht përpjekjeve për zgjidhje, më 24 shkurt 2025, prindi vendosi ta ndërpresë ndjekjen e procesit mësimor të fëmijës.

Gjatë komunikimeve dhe takimeve të zhvilluara me prindin e fëmijës, staf i drejtues dhe mbështetës ka propozuar disa zgjidhje për shqetësimet e ngritura nga prindi. Drejtoria e Shkollës, në bashkëpunim me Shërbimin Psiko-Social, ka ofruar një sërë alternativash dhe masa mbështetëse për ndjekjen e suksesshme të procesit mësimor nga nënësi A. H.

Konkretisht:

- *I është sugjeruar prindit shoqërimi i fëmijës gjatë zhvillimit të orëve mësimore, me qëllim rritjen e sigurisë dhe përfshirjes së tij në procesin edukativ. Gjithashtu, prindit i është dhënë mundësia të shprehë preferencën për përzgjedhjen e mësueses ndihmëse, me qëllim krijimin e një marrëdhënieje sa më të mirë bashkëpunimi dhe besimi me fëmijën.*
- *Po ashtu, i është sugjeruar mundësia e asistencës në kushte shtëpie nga ana e mësueses ndihmëse, në rastet kur ndjekja e procesit mësimor në ambientet e Shkollës është refuzuar.*
- *Për çdo kërkesë të paraqitur nga prindi, Shërbimi Psiko-Social i Shkollës ka ofruar mbështetje të vazhdueshme dhe të menjëhershme, në funksion të mirëqenies dhe përfshirjes së nxënësit në sistemin arsimor.*
- *Megjithatë, të gjitha këto mundësi të ofruara nga Shkolla janë refuzuar kategorikisht nga prindi, duke mos e sjellë fëmijën në Shkollë, pa na lejuar të dëgjojmë drejtpërdrejtë mendimin dhe përjetimet e fëmijës.*

Theksojmë se në njoftimet e psikologes për mbledhjen e Komisionit AK, në Shkollë, z. H ndër vite nuk është paraqitur rregullisht. Ka shmangur këto mbledhje që janë shumë të rëndësishme për miratimin dhe dakordësinë e tij për përmbytjen e planit PEI, duke mos i dhënë mundësinë Komisionit të shqyrtojë pretendimet e prindit për të bërë ndryshimet e kërkuara.

Komisioni Ad-Hoc në Shkollë mbledhet 3 herë gjatë vitit shkollor, por dhe më shumë (në rast të nevojave dhe bazuar në interesin më të lartë të fëmijës). Mësuesi lëndor dhe mësuesit mbështetës njihen me specifikat e diagnozës dhe me vlerësimin psiko-social të fëmijës ku jepen udhëzimet për hartimin e planeve PEI.

Psikologia e Shkollës ka ofruar të gjithë mbështetjen e nevojshme profesionale për ndjekjen e planit PEI, me synimin për t'i garantuar fëmijës një arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës.

Pavarësisht se z. A. H ka refuzuar të firmosë dhe të jetë pjesë aktive në procesin e PEI, Shkolla, në bashkëpunim me psikologun, mësuesin mbështetës dhe Komisionin e AK, ka vazhduar pa ndërpreje punën me fëmijën, duke i garantuar atij pjesëmarrje të rregullt në procesin mësimor, zhvillim personal dhe socializim me bashkëmoshatarët.

Nga shqyrtimi i situatës rezulton se pretendimet e përsëritura të z. H, të paraqitura në formë dhe institucione të ndryshme, shpesh nuk janë mbështetur në fakte konkrete apo shkelje nga ana e Shkollës, por përkundrazi kanë penguar ndonjëherë edhe mbarëvajtjen e procesit të rregullt mësimor dhe arsimor.

Gjithashtu, dëshirojmë të sqarojmë se institucioni jonë ka bashkëpunuar me të gjitha institucionet përkatëse, përfshirë Agjencinë e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Avokatin e Popullit, duke vënë në dispozicion të plotë çdo dokumentacion, fakt, e të dhëna që lidhen me këtë rast.

Që prej periudhës së shkëputjes së nëxënësit A. H nga Shkolla, në mënyrë të vazhdueshme kohë e pa kohë, duke tejkaluar çdo kompetencë konfidencialiteti zyrtar të marrëdhënies me pozicionin tim si drejtuese, prindi dërgon video të papërshtatshme të djalit si: duke i mësuar makinën apo futur kokën në govatë me ujë dhe të tjera si këto, të cilat cenojnë sigurinë fizike të fëmijës.

Në mbledhjen e Grupit Ndërsektorial pranë Njesisë Administrative nr. 8, të mbajtur me datë 24.04.2025, u vendos realizimi i një vlerësimi psikologjik të fëmijës nga një ekspert i jashtëm, me qëllim identifikimin e gjendjes emocionale dhe nevojave të tij. Edhe kjo kërkesë është refuzuar nga prindi, duke penguar bashkëpunimin për një zgjidhje të shpejtë dhe efektive të situatës.

Theksojmë se Shkolla mbetet gjithmonë e hapur për bashkëpunim institucional, në funksion të garantimit të interesit më të lartë të fëmijës, të drejtës për arsim cilësor, përfshirje, zhvillim dhe mirëqenie psikologjike.

Është ftuar z. H bashkë me fëmijën për të vlerësuar gjendjen psiko-emocionale të fëmijës nga psikologia e Shkollës, lidhur me momentin që prindi pretendon se fëmija refuzon të vijë në Shkollë, por nuk ka bashkëpunuar dhe në këtë rast, duke mos na lejuar të dëgjojmë drejtpërdrejtë mendimin dhe përjetimet e fëmijës.

Është e rëndësishme që, në interesin më të mirë të fëmijës, t'i japim atij hapësirën për të shprehur ndjenjat dhe përjetimet e tij në mënyrë të pavarur. Nga komunikimet dhe vëzhgimet e kryera nga Shërbimi Psiko-Social, kemi konstatuar një mospërputhje midis shqetësimeve të ngrituara nga prindi dhe sjelljes së fëmijës në ambientet e Shkollës.

Në bazë të vëzhgimeve, vlerësimeve psikologjike ndër vite, përfshirë edhe këtë vit akademik, konstatohet se fëmija vjen me dëshirë në Shkollë dhe se angazhohet në procesin mësimor.

...që në klasën përgatitore, që prej vitit 2018, nxënësi A. H është ndjekur rregullisht me mësuese ndihmëse, me orar të përcaktuar dhe ka punuar me plan edukativ individual/ PEI.

Nxënësi është vlerësuar nga Komisionet Multidisiplinare që prej shtatorit 2019, e çdo fillim viti shkollor (edhe pse fillimisht ka refuzuar ta sjellë fëmijën në Komision), ka marrë numrin maksimal të orëve nga mësueset ndihmëse, ka punuar me PEI dhe ka realizuar objektivat e caktuara.

Mësueset ndihmëse, të këruara zyrtarisht nga Drejtoria e Shkollës, që kanë punuar me nxënësin A. H, duke filluar nga muaji shkurt 2018 e në vijim, janë dërguar nga Drejtoria Arsimore Rajonale e Zyra Vendore Arsimore, bazuar në vendimet e Portalit “Mësues për Shqipërinë”, si dhe në aktet ligjore e nënligjore të kohës dhe kanë zbatuar kontratat respektive.

Mësueset me kontrata të përkohshme nuk kanë marrë emërim definitiv për shkak se nuk kanë qenë të arsimit special. Mësuesja M. M, është mësuese e emëruar me kontratë të përhershme pasi është e profilizuar në arsimin special.

Edhe pasi në Shkollë u emërua mësuese me arsim special, z. H pas një viti ngriti pretendimin se nuk e pranon këtë mësuese, pasi nuk është ende prind dhe nuk ka fëmijë.

Gjatë viteve shkollore që nga 2017 e deri në 2025, rregullisht z. H është pritur në Shkollë për të paraqitur shqetësimet e tij, të cilat shpesh i ka drejtuar tek Shërbimi Psiko-Social, në Drejtorinë e Shkollës.

Në vitin 2017-2018, z. H është pritur rregullisht nga Drejtori e Nën/drejtori ku ka adresuar shqetësimin e tij lidhur me numrin e madh të fëmijëve në klasën përgatitore, për nivelin e ndotjes së ajrit, për incident të vogla mes fëmijës së tij dhe fëmijëve të tjerë të klasës, si dhe për problemin e vendosjes së kazanëve të mbeturinave në afërsi të territorit të Shkollës, etj. Gjithmonë është dëgjuar me vëmendje dhe janë verifikuar të gjitha indiciet e dhëna prej tij. Disa prej problemeve, zgjidhja e të cilave varej nga Shkolla u janë dhënë zgjidhje të menjëhershme, po ashtu është adresuar tek Instituti i Higjenës, problematika e adresuar prej tij lidhur me nivelin e ndotjes së ajrit në Shkollë.

Në klasën e I, A, u regjistrua në klasën I A, me mësuese A. H, dhe ndoqi mësimin nga shtatori 2018 e deri në përfundimin e klasës së pestë, në qershor 2023.

Gjatë mësimin në klasat e arsimit fillor, A ka ndjekur mësimin dy orë mësimore, nga ora 08:00 deri në orën 10:00, ka pasur ecuri të kënaqshme në zbatimin e PEI.

PEI- t janë krijuar nga mësuesja ndihmëse në bashkëpunim me mësuesen e klasës dhe kanë marrë në çdo periudhë tremujore, miratimin e Komisionit Shkollor për nxënësit me AK. Këto plane i janë dhënë për miratim edhe prindit z. H.

Z. H është ftuar rregullisht në takimet me prindër dhe aktivitetet e organizuara në Shkollë, por ka refuzuar të marrë pjesë me përjashtim të takimit të parë me prindër në klasë të parë, ku ka shpërndarë disa fletushka në të cilat rendiste pakënaqësitë e tij ndaj menaxhimit të punëve në qytetin e Tiranës, por asnjë problematikë lidhur me Shkollën.

Në muajin shkurt 2019 është thirrur në mbledhjen e këshillit të prindërve, për t'u dëgjuar për shqetësimet e tij, mbledhje në të cilën ka reaguar i revoltuar por pa paraqitur asnjë ankesë ndaj Shkollës.

Lidhur me çështjen e oficerit të sigurisë në Shkollë, në reference me parashikimet ligjore, Shkolla jonë për vitin shkollor 2024-2025, nuk ka përmbushur kriterin e numrit të nxënësve.

Të gjitha pretendimet dhe ankesat e shumta të parashtruara gjatë këtyre viteve nga prindi, z. H drejtuar institucionit tonë janë bërë gojariht, jo në formë zyrtare. Pavarësisht këtij fakti të rëndësishëm, i gjithë institucioni me palët përkatëse: stafi drejtues, mësueset kujdestare, mësues lëndor, mësues ndihmës dhe staf psiko-social, jemi treguar të gatshëm dhe jemi angazhuar me seriozitet në përmbushjen e çdo nevojë dhe pretendimi të prindit për të siguruar mirëqenien e fëmijës.

Pavarësisht rrethanave, situatave dhe ngërçeve të krijuara nga vetë z. H, ne si institucion përtej detyrës dhe punës që na takon, jemi të gatshëm të ofrojmë bashkëpunimin, përkushtimin tonë, duke u udhëhequr në punën tonë të përditshme nga parimi se, mbi çdo gjë mbetet interesi më i lartë për fëmijët.”

- 3. Nëpërmjet shkresës me nr. 4676/1 prot., datë 27.06.2025, ZVAP Tiranë ka dërguar parashtrime, duke informuar ndër të tjera, se:**

“...Në respektim të parashikimeve përkatëse ligjore, Komisioni Multidisiplinar, i ngritur pranë ZVAP Tiranë, ka kryer procesin e vlerësimit të nevojave arsimore në vijimësi për nxënësin A. H, me kërkesë të shkollës 9-vjeçare “4 Dëshmorët”, Tiranë, ku nxënësi është i regjistruar.

Nxënësi është paraqitur pranë Komisionit dhe është vlerësuar në prani të prindit, psikologut të IA, dhe mësueses ndihmëse, për çdo vit shkollor.

Gjatë procesit të vlerësimit, Komisioni ka dhënë rekomandimet përkatëse, ka përcaktuar orët mësimore ku nxënësi do të asistohet me mësues ndihmës në përputhje me specifikat e diagnozës, ecurinë e fëmijës, nevojat e vlerësuara, mundësinë për të nxitur fëmijën drejt pavarësisë dhe ka dhënë udhëzimet përkatëse për hartimin e PEI.

Nga ana e Komisionit është vlerësuar një ecuri e mirë e nxënësit dhe nuk janë vlerësuar vështirësi lidhur me frekuentimin apo sjellje refuzuese të fëmijës ndaj mjedisit të Shkollës.

ZVAP Tiranë i ka përcjellë zyrtarisht Shkollës, rekomandimet e Komisionit çdo vit shkollor në përfundim të çdo faze vlerësimi.

Nga verifikimi i dokumentacionit dhe procedurave të ndjekura nga Komisioni, rezulton se nxënësi në fjalë është ndjekur me mënues ndihmës që nga klasa e parë dhe vijon të mbështetet edhe për vitin shkollor 2024-2025, me tre orë mësimore në ditë, në përputhje me vendimin e Komisionit Multidisiplinar të ZVAP Tiranë, duke përfutur maksimumin e këtij shërbimi, bazuar në përcaktimet e akteve nënligjore në fuqi

Gjatë procesit të rivlerësimit të nevojave arsimore të nxënësve me AK, në periudhën Maj-Qershor 2025, rezulton se prindi nuk ka paraqitur nxënësin pranë Komisionit, për rivlerësimin e nevojave arsimore të fëmijës dhe përfitimin e shërbimeve mbështetëse pranë Shkollës për vitin e ardhshëm shkollor.

Nga informacioni i përcjellë nga Shkolla rezulton se nxënësi ka frekuentuar Shkollën rregullisht me kohë të pjesshme, i shoqëruar nga mësuesi ndihmës 3 (tre) orë mësimi në ditë, deri më datë 24.02.2025. Pas kësaj date nxënësi nuk ka frekuentuar Shkollën dhe arsyeja që prindi ka paraqitur ka qenë se, fëmija refuzon të frekuentojë Shkollën.

Referuar dokumentimit të komunikimeve dhe vëzhgimeve të kryera nga institucioni arsimor dhe shërbimi psiko-social, është konstatuar një mospërputhje mes pretendimeve të ngritura nga prindi dhe sjelljes së fëmijës në ambientet e Shkollës, nga ku konstatohet se fëmija vjen me dëshirë në Shkollë dhe angazhohet në procesin mësimor.

ZVAP Tiranë, bazuar në parashikimet përkatëse ligjore, ka punësuar mësues ndihmës, në përputhje me orët mësimore të rekomanduara nga Komisioni Multidisiplinar.

Në zbatim të legjislacionit dhe rekomandimit të Komisionit, Drejtori i Shkollës ka caktuar për çdo vit shkollor mësuesin ndihmës për nxënësin A. H.

Çdo vit shkollor, z. H ka paraqitur pakënaqësi lidhur me punën e mësuesve ndihmës të caktuar për asistimin e fëmijës së tij, të cilat institucioni i ka trajtuar në kohë dhe hap pas hapi dhe ka konstatuar se pretendimet e tij nuk qëndrojnë, pasi veprimet e mësuesve kanë qenë në përputhje me detyrimet profesionale që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi.

Drejtoria e Shkollës ka trajtuar kërkesat e tij dhe i ka mundësuar disa herë ndryshimin e mësueseve ndihmëse, por pretendimet e tij kanë vijuar të jenë të njëjta pavarësisht ndryshimeve dhe masave të ndërmarra nga Shkolla.

Lidhur me trajtimin e rastit në fjalë, ZVAP Tiranë, ka mbajtur në mënyrë të vazhdueshme kontakte me Shkollën, e cila i ka të dokumentuara çdo shërbim dhe mbështetje të ofruar ndaj nxënësit, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe të gjitha komunikimet dhe takimet e zhvilluara me prindin e fëmijës A. H, stafin drejtues, shërbimin psiko-social dhe atë mbështetës, me qëllim bashkëpunimin në interesin më të lartë të fëmijës. Pavarësisht të gjitha mundësive të ofruara nga Shkolla, rezultonte se të gjitha këto shërbime janë refuzuar kategorikisht nga prindi, duke mos e sjellë fëmijën në Shkollë.

Lidhur me mungesën e frekuentimit të Shkollës, rasti është në trajtim nga Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve, Njësia administrative nr.4, ku ZVAP Tiranë ka pasur përfaqësues në të gjitha takimet e realizuar dhe ka ndjekur me përparësi rastin.

Lidhur me mungesën e oficerit të sigurisë në Shkollë, në referencë të Vendimit nr. 600, datë 09.10.2018, të Këshillit të Ministrave, ku parashikohet që, oficerë sigurie caktohen në shkollat me mbi 700 nxënës, shkolla 9-vjeçare “4 Dëshmorët”, Tiranë, nuk ka përfituar oficer sigurie, referuar numrit më të vogël të nxënësve.

Në prill të vitit 2025, me ndryshimin e pësuar në legjislacionin përkatës, ku përcaktohet se, “Institucionet e arsimit bazë ose shkollat e bashkuara që kanë mbi 350 nxënës, të kenë një oficer sigurie”, shkolla 9-vjeçare “4 Dëshmorët”, përmbush kriterin e numrit të mësipërm të nxënësve dhe do të përfitojë nga vendosja e një oficeri sigurie, për vitin shkollor 2025-2026.”.

4. Nëpërmjet shkresës me nr. 3726/1 prot., datë 03.07.2025, MAS, ka dërguar kopje të korrespondencës, kthim përgjigjeve drejtuar z. A. H.
5. Në vijim të procedurës hetimore, për një gjykim sa më të drejtë të kësaj çështjeje dhe për të zhvilluar një proces të drejtë ligjor, në zbatim të parimit të kontradiktoritetit, mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 847/9 prot., datë 14.08.2025, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore.

Palëve iu është bërë e ditur, se gjatë seancës kanë të drejtë të depozitojnë në cilësi prove çdo informacion plotësues ose akt administrativ, të cilin ende nuk e kanë paraqitur pranë KMD-së dhe që vlerësojnë se ka rëndësi për përcaktimin e gjendjes së fakteve e rrethanave të çështjes.

6. Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 11.09.20257, pranë Zyrës së Komisionerit, në mungesë të palës ankuese, prindit të nxënësit A. H, dhe me praninë e: znj. O. J, përfaqësuese

me Autorizim⁴ e ZVAP Tiranë, dhe znj. I. C (me detyrë punonjëse e Shërbimit Psiko-Social) dhe znj. D. Z (me detyrë psikologe), përfaqësuese me Autorizim⁵ të Shkollës.

Përfaqësueset e Shkollës dhe ZVAP Tiranë, gjatë seancës u qëndruan të njëjtave parashtrime dhe argumenta të komunikuar dhe shkresërisht para KMD-së, duke evidentuar faktin se fëmija ka përparuar shumë në procesin mësimor, shpreh emocionet, zbaton udhëzimet që i jepen nga mësueset që punojnë me të, të gjithë e duan dhe mbështesin A. Problemi sipas tyre, qëndron tek prindi i fëmijës, i cili është jobashkëpunues dhe paraqet kërkesa që janë përtej programit shkollor.

Përfaqësueset e Shkollës evidentuan se kanë ndjekur të gjithë hapat ligjorë të nevojshme dhe se, në kushtet konkrete (të refuzimit të bashkëpunimit të prindit me Shkollën) e kanë referuar rastin për ndjekje tek Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve.

7. Me shkresën me nr. 847/10 prot., datë 16.09.2025, Komisioneri ka kërkuar nga Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve, pranë Njesisë Administrative Nr. 8, Tiranë, informacion dhe dokumentacionin respektiv, në kuadër të masave dhe hapave të ndjekur për menaxhimin e rastit të nxënësit A. H.
8. Nëpërmjet shkresës me nr. 2309/1 prot., datë 24.09.2025, Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve pranë Njesisë Administrative nr.8, Tiranë, ka dërguar pranë KMD-së, një relacion mbi ecurinë dhe hapat e ndjekura lidhur me ecurinë dhe hapat e menaxhimit për rastin e fëmijës A. H, duke cituar se:

“Ju bëjmë me dije se, referimi është bërë nga babai i fëmijës, z. A. H, i cili ka shprehur shqetësimin për refuzimin e djalit të tij për të frekuentuar shkollën, për shkak të dhunës dhe ofendimeve që sipas tij, i janë bërë fëmijës në klasë.

Gjatë referimit të kryer tek Alo 116 111, z. H deklaroi se stafi psiko-social i Shkollës nuk ka marrë masa konkrete për normalizimin e situatës dhe se për këtë arsye ai refuzon të bashkëpunojë me psikologun dhe mësuesen.

Pas marrjes së referimit, PMF 8, ka nisur menaxhimin e rastit, ka kontaktuar babain dhe ka kryer vizita në familje dhe në Shkollë, si dhe është vënë në komunikim me institucionet përgjegjëse. Hapat e menaxhimit vijnë si më poshtë:

- Në datën 21.03.2025 – PMF së bashku me SPZ, kanë shkuar në banesën e familjes për të kryer vlerësimin social-ekonomik. Z. H njoftoi se ndodhej jashtë banesës dhe vizita u planifikua për një ditë tjetër. Po në datë 21.03.2025, z. H paraqitet pranë Njesisë Administrative nr. 8 dhe paraqet historinë e djalit, si dhe problematikat gjatë martesës me nënën e fëmijës, znj. S. Ai shprehet se djali është bullizuar në Shkollë dhe nuk ka siguri për të ndjekur mësimin.

⁴ Autorizim me nr. 8803 prot., datë 11.09.2025, e ZVAP Tiranë.

⁵ Autorizim me nr. 195 prot., datë 11.09.2025, e shkollës 9-vjeçare “4 Dëshmorët”, Tiranë.

- Në vijim, PMF, ka zhvilluar takim me stafin psiko-social të Shkollës, ku u konstatua se babai shpesh rezulton jo bashkëpunues dhe se kjo përbën një pengesë për ndjekjen e mësimin nga fëmija.
- Nga Shkolla është konfirmuar se janë ofruar mundësi për mësues ndihmës dhe për mbështetje shtesë, por babai shpesh nuk ka pranuar bashkëpunimin.
- Në datën 28.03.2025, është realizuar vizita në banesën e familjes, ku fëmija refuzoi të dilte nga dhoma e tij. Takimi u zhvillua në prani të gjyshërve, të cilët deklaruan se babai është kujdesur vazhdimisht për djalit.
- Gjatë menaxhimit, babai ka dërguar përmes aplikacionit WhatsApp video, foto, dokumente, me qëllim dokumentimin e kujdesit që i ofron djalit. Gjatë periudhës së pushimeve verore, janë kryer komunikime nëpërmjet telefonit për t'u vënë në dijeni si është mirëqenia e fëmijës.

Në lidhje me mbledhjet e Grupit Teknik Ndërsektorial, të kryera nga PMF pranë Njesisë Administrative nr. 8, ju informojmë se:

- Në datën 01.04.2025, u zhvillua mbledhja e parë e GTN, dhe u vendos që babai të angazhohej për të motivuar djalit e tij të rikthehej në Shkollë, si dhe ndjekjen e seancave të këshillimit nga ana e Shkollës.
- Në datën 28.04.2025, u zhvillua mbledhja e dytë e GTN, ku u konstatua mungesa e progresit për shkak të refuzimit të vazhdueshëm të babait për bashkëpunim dhe u vendos marrja e grumbullimit të informacionit nga ana e Shkollës si dhe dërgimi me shkresë zyrtare drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë në lidhje me kujdestarinë e djalit.
- Në datën 22.09.2025, u zhvillua mbledhja e tretë e GTN, ku prindi i fëmijës u thirr nëpërmjet shkresës zyrtare dhe u konstatua se fëmija nuk po frekuenton Shkollën dhe se pengesë për frekuentimin dhe integrimin e fëmijës në shoqëri po bëhet babai, i cili nuk dërgon fëmijën në shkollë.
- Në mbledhjen e GTN, u vendos masa e mbikëqyrjes së specializuar në mjedisin familjar, sipas nenit 58/1, të ligjit nr. 18/2017, si dhe dërgimi me shkresë zyrtare për marrjen e informacionit nga Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor, nëse ka kryer vlerësimin psiko-social tek psikiatri infantile për fëmijën A. H.
- Një nga hapat e kryera të menaxhimit të rastit është dhe dërgimi me shkresë zyrtare drejtuar Qendrës Shëndetësore nr. 3, ku kërkojmë bashkëpunimin e tyre për të dhënë një rekomandim që të kryhet një vlerësim psiko-social nga psikiatri i fëmijëve infantil. Nga informacionet që disponojmë rezulton se babai nuk e ka dërguar fëmijën për vizitë, duke deklaruar se nuk e sheh të nevojshme. Ky vlerësim konsiderohet i domosdoshëm për të përcaktuar më qartë nevojat psiko-emocionale të fëmijës. Gjithashtu, PMF 8, ka informuar z. H për detyrimin ligjor për të dërguar fëmijën në Shkollë, si pjesë e arsimit të detyrueshëm.

- Në mbledhjen e fundit të GTN, u vendos të kryhej një vizitë në banesë pas përfundimit të mbledhjes, ku ju informojmë se:
 - PMF 8 dhe SPZ zhvilluan vizitë në banesën e z. H. Në momentin e mbërritjes, fëmija hyri menjëherë në garazh. PMF 8, kërkoi të ngjitej në banesë për të parë fëmijën, por babai refuzoi kategorikisht. Gjatë përpjekjes për të pasur kontakt me fëmijën, z. H bëri që fëmija të reagoonte me nervozizëm. Fëmija mori nga garazhi një çelës anglez dhe e drejtoi ndaj PMF-së, si reagim mbrojtës, për shkak të perceptimit të situatës së konflikt. Në atë moment, z. H mbylli portën e garazhit dhe i komunikoi fëmijës të mos komunikonte me PMF. SPZ, i bëri me dije z. A se po pengonte një proces ligjor dhe institucional për mbrojtjen e fëmijës, por z. A në mënyrë të tensionuar, kërkoi largimin tonë nga banesa dhe e shoqëroi fëmijën drejt shtëpisë.”
9. Nëpërmjet shkresës me nr.9014/1 prot., datë 07.10.2025, ZVAP Tiranë, (lidhur me kërkesën e KMD-së, se si veprohet ligjërisht dhe institucionalisht në rastet kur prindi bëhet pengesë reale për mosfrekuentimin e procesit mësimor të fëmijës së tij) informon Komisionerin se:

“Në rastet kur prindi nuk paraqet një deklaratë me shkrim për largimin e fëmijës, dhe në vlerësimin e institucionit arsimor rezulton se prindi po bëhet pengesë për arsimin e fëmijës, Shkolla, pasi ka zhvilluar të gjitha takimet informuese dhe i ka bërë me dije prindit detyrimin ligjor për arsimimin e fëmijës së tij, referon rastin, 3 (tri) javë pas fillimit të vitit shkollor, pranë Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve (PMF) në njësinë administrative përkatëse, duke e trajtuar si rast të nxënësit braktisës.

Pas referimit, PMF, bëhet menaxher i rastit dhe kryen të gjitha vlerësimet e nevojshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Më pas, PMF, thërret Grupin Teknik Ndërinstitucional (GTV), i cili përfshin të gjithë aktorët institucionalë të nevojshëm për menaxhimin e rastit.”

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe të pafavorshëm të nxënësit A. H, të përfaqësuar nga prindi z. A. H, nga ana e Shkollës 9-vjeçare “4 Dëshmorët”, Tiranë.

Në nenin 1 të ligjit nr. 1021/2010, i ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, afhtësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1, sipërcituar dhe nenin 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e subjektit për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

LMD, i ndryshuar, në nenin 32/2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij”.*

Në vështrim të legjislacionit që rregullon sistemin arsimor parauniversitar, Komisioneri evidenton se:

Në nenin 5/1 dhe 6, të ligjit nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se:

“5. 1. Në Republikën e Shqipërisë garantohej e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, mosha, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar.

..

6/1. Në veprimtaritë e institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar, interesi i nxënësit është parësor.

6/2. Në sistemin arsimor parauniversitar respektohen, mbrohen dhe promovohen të drejtat e liritë e njeriut në përgjithësi dhe të drejtat e fëmijëve në veçanti.

6/3. Në sistemin arsimor parauniversitar, nxënësve dhe punonjësve u ofrohet mbrojtje nga çdo formë veprimi ose mosveprimi që mund t’u shkaktojë diskriminim, dhunë, keqtrajtim ose dëm moral.

6/4. Në institucionet arsimore zbatohet parimi i gjithëpërfshirjes së nxënësve.

6/5. Çdo nxënësi i sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim.

6/6. Nxënësve të familjeve në nevojë, nxënësve me aftësi të kufizuara dhe atyre me vështirësi në të nxënë u ofrohet përkujdesje e posaçme, sipas përcaktimeve në këtë ligj...”

Në nenin 20⁶, të Ligjit, përcaktohet se:

“1. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, u sigurojnë shërbim psiko-social nxënësve dhe punonjësve të institucioneve arsimore.

2. Shërbimi psiko-social ofron mbështetje nëpërmjet psikologëve ose punonjësve socialë për trajtimin e problematikave të rasteve të ndryshme, vlerësimin e rasteve të fëmijëve me nevoja të veçanta psiko-sociale, hartimin e programeve parandaluese, sipas nevojave të komunitetit shkollor.”

Neni 28⁷, i Ligjit, parashikon se:

“1. Njësia bazë e vetëqeverisjes vendore ka për detyrë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit arsimor për të gjithë nxënësit në institucionet arsimore parauniversitare publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

.....

3. Njësia bazë e vetëqeverisjes vendore, në bashkëpunim me institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore publike, është përgjegjëse për regjistrimin e nxënësve në shkollat publike të arsimit të detyrueshëm me kohë të plotë.

4. Njësia bazë e vetëqeverisjes vendore, mbështetur në propozimet e institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar dhe këshillat e mësuesve të institucioneve, sipas kriterëve të miratuara në këshillat e njësive vendore, mbështet:

a) nxënësit e familjeve në nevojë;

b) nxënësit me arritje të shkëlqyera;

c) punonjësit e institucioneve arsimore për zhvillimin e tyre profesional dhe për zhvillimin e kurrikulës;

ç) pajisjen e institucioneve arsimore me mjete mësimore;

d) nxënësit me aftësi të kufizuara.”

Në nenin 54, të ligjit nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se drejtori i institucionit arsimor: *“1. Drejtori drejton veprimtarinë e institucionit arsimor. 2. Drejtori i institucionit arsimor, publik ose privat, është përgjegjës për: a) zbatimin e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij; b) c)..... ç).....”.*

Në nenin 62 të ligjit 69/2012, të ndryshuar, parashikohet se: *“Të drejtat dhe detyrat e prindërve:*

...

2. Prindi ka të drejtë:

⁶ Shërbimi psiko-social në institucionet arsimore

⁷ Njësia bazë e vetëqeverisjes vendore

a) të informohet nga institucioni arsimor përkatës për legjislacionin arsimor në fuqi, për rregulloren e institucionit dhe për kurrikulën që institucioni i ofron fëmijës së tij;

b)

c) të informohet për veprimtarinë e fëmijës së tij në institucion dhe të japë pëlqim për veprimtaritë plotësuese dhe jashtëshkollore që organizon shkolla;.....

3. Prindi ka detyrë:

a) të kujdeset që fëmija i tij të ndjekë rregullisht institucionin arsimor dhe të mësojë rregullisht;

b) të njoftojë për ndryshime të shëndetit dhe të sjelljes së fëmijës së tij;

c) të marrë pjesë në takimet për që kanë të bëjnë me fëmijën e tij;”.

Neni 63⁸, i Ligjit, parashikon se:

“1. Arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara synon zhvillimin e plotë të potencialit intelektual e fizik dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre për t’i përgatitur për gjithëpërfshirje në shoqëri dhe në tregun e punës.

2. Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet e arsimit special për ta është përgjithësisht e përkohshme. Përfshirja dhe integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e zakonshme të arsimit bazë është parësore.

3. Nxënësve me aftësi të kufizuara në dëgjim, shikim dhe komunikim u garantohej drejta e edukimit në gjuhën e shenjave, e drejta e përdorimit të shkrimit Brail, si dhe e mjeteve didaktike në formë elektronike, të specializuara në funksion të edukimit të tyre.”

Neni 64⁹, parashikon se: “

“1. Nxënësve me aftësi të kufizuara u sigurohet arsimimi në shkollat e arsimit të mesëm të lartë, sipas kritereve të miratuara nga ministri dhe Ministri i Shëndetësisë.

2. Nxënësi me aftësi të kufizuara qëndron në shkolla të specializuara deri në moshën 19 vjeç.

3. Insitucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, krijon një komision, të përbërë nga mjekë, psikologë, mësues dhe specialistë për fëmijët me aftësi të kufizuara, i cili, pasi shqyrton kërkesën e prindit ose të drejtorit të një institucioni arsimor, jep rekomandimet përkatëse për ndjekjen nga fëmija të një institucioni arsimor të zakonshëm a të specializuar.

4. Prindërit vendosin nëse fëmija e tyre me aftësi të kufizuara do të ndjekë një institucion të specializuar ose të zakonshëm të arsimit bazë. Prindërit mund të largojnë në çdo kohë nga shkolla fëmijën, kur e gjykojnë se ai nuk përfiton nga mësimet ose ka mundësi të tjera më të mira.

5. Ministria, në bashkëpunim me njësinë bazë të vetëqeverisjes vendore dhe në këshillim me prindërit e komisionin, siguron arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në njërin nga dy llojet e institucioneve arsimore, të zakonshme ose të specializuara.

6. Insitucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe të Ministrit të Shëndetësisë, i siguron arsimim në shtëpi nxënësve që nuk mundin të ndjekin një shkollë të zakonshme ose të

⁸ Parime të arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara

⁹ Ndjekja e institucioneve arsimore nga fëmijët me aftësi të kufizuara

specializuar të arsimit bazë.”

Në neni 65¹⁰, të Ligjit, përcaktohet se:

“1. Nxënësit me aftësi të kufizuara mësojnë sipas planit mësimor e programeve lëndore të zakonshme, të përshtatura për ta, ose sipas planit mësimor e programeve lëndore të specializuara për ta.

2. Në institucionet arsimore të zakonshme, programi i personalizuar për nxënësin me aftësi të kufizuara hartohet nga një komision, në përbërje të të cilit janë mësues të fushave të ndryshme të të nxënës të institucionit e psikologë. Hartimi i këtij programi bëhet në bashkëpunim me prindërit e nxënësit. Ndryshimi i programit të personalizuar brenda një institucioni arsimor vendoset nga komisioni brenda institucionit, në bashkëpunim me prindërit e fëmijës.

3. Nxënësve me aftësi të kufizuara u sigurohen mësues ndihmës dhe shërbim rehabilitues, sipas kritereve të përcaktuara me udhëzim të ministrit. Punonjësit arsimorë të institucioneve, që kanë nxënës me aftësi të kufizuara, certifikohen në programe trajnimi për trajtimin e këtyre nxënësve.

4. Njësia përkatëse bazë e vetëqeverisjes vendore u siguron nxënësve me aftësi të kufizuara mjediset e përshtatshme të mësimdhënies e të të nxënës, sipas standardeve të përcaktuara nga ministria.”

Neni 68, i Ligjit, lidhur me ndjekjen e arsimit të detyrueshëm, përcakton se:

“Mosregjistrimi dhe mungesat e paarsyeshme të fëmijës në mësim për më shumë se 25 për qind të orëve mësimore gjatë një viti shkollor vlerësohen si rast i neglizhencës prindërore dhe trajtohen në përputhje me ligjin nr.10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”. ”Ligji nr. 17/2017 “Për të Drejtat e Fëmijës”, përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës.

Neni 6, i Ligjit, sanksionon zbatimin e interesit më të lartë të fëmijës:

“1. Ky ligj, aktet e tjera normative që rregullojnë çështjet që lidhen me zbatimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe çdo akt tjetër individual, që nxirret mbi bazë të tyre, i nënshtrohet parimit të interesit më të lartë të fëmijës.

2. Autoritetet publike e jopublike, si dhe gjykatat, kanë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës në të gjitha veprimet dhe vendimet që merren në lidhje me fëmijët.

3. Interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën. Në zbatimin e këtij parimi mbahen parasysh:

a) nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri si dhe rritjen/përkatësinë në një familje;

b) mendimi i fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar;

c) historia e fëmijës, duke mbajtur parasysh situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në

¹⁰ Organizimi i arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara

të ardhmen;

ç) aftësia e prindërve ose personave që kujdesen për mirërritjen e fëmijës për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijës;

d) vazhdimësia e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave, me të cilët ai ka lidhje gjinore, shoqërore dhe/ose shpirtërore.”

E drejta për arsimim, përcaktohet si vijon në nenin 18, të Ligjit:

“1. Fëmija ka të drejtën e aksesit dhe të frekuentimit të arsimimit falas e cilësor, në bazë të mundësive të barabarta dhe pa diskriminim, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar. Kjo e drejtë i garantohet edhe fëmijës që dëshiron të vazhdojë të arsimohet pas përfundimit të arsimit të detyrueshëm.

2. Prindi ose kujdestari merr masa të përshtatshme që fëmija të ndjekë arsimin e detyrueshëm ose nivele të tjera të arsimimit, sipas dëshirës së fëmijës, si dhe të garantojë frekuentimin e rregullt të tij dhe pa pengesa.

3. Ministria përgjegjëse për arsimin parauniversitar, si autoritet publik përgjegjës, si dhe njësitë arsimore vendore marrin masa konkrete, me qëllim që:

a) të mundësojnë aksesin e fëmijës në arsimin parashkollor, si dhe arsimin e detyrueshëm falas për të gjithë fëmijët, edhe në rastet kur fëmijët mund të kenë kaluar moshën për arsimin e detyrueshëm, por kanë qenë në pamundësi për ta ndjekur atë;

b) të zhvillojnë, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë, programe edukimi për prindërit, përfshirë programe për parandalimin e dhunës në familje;

c) të organizojnë plane mësimore të veçanta për fëmijën që nuk arrin nivelet e duhura që synon programi mësimor, me qëllim parandalimin e largimit nga shkolla para kohe të fëmijës;

ç) të organizojnë plane mësimore të veçanta edukimi për fëmijët që braktisin shkollën ose që nuk e kanë frekuentuar asnjëherë apo për fëmijët që kthehen nga qëndrimi jashtë vendit, ose pranë institucioneve joshkolllore, me qëllim integrimin e tyre në sistemin kombëtar të edukimit;

d) të mbikëqyrin të drejtën e fëmijës për t'u çlodhur, si dhe të drejtën për të marrë pjesë në aktivitete kulturore e artistike;

dh) të marrin masa konkrete për ofrimin e shërbimeve sociale brenda mjediseve të shkollës, si ushqim, transport e të tjera, me qëllim parandalimin e braktisjes së shkollës për arsye ekonomike;

e) të krijojnë kushtet e nevojshme, me qëllim rritjen e cilësisë së arsimimit, nëpërmjet kurrikulave, mjeteve mësimore, infrastrukturës së përshtatshme, si dhe të vlerësimit periodik të personelit mësimor;

ë) të sigurojnë burime të mjaftueshme dhe të përshtatshme njerëzore, materiale e financiare për të siguruar arsimimin cilësor të fëmijës;

f) të ndërmarrin veprime konkrete për të garantuar të drejtën e arsimimit të fëmijës që i përket grupeve ose rajoneve me mangësi të konsiderueshme edukimi ose që është në situata të vështira sociale, ekonomike ose gjendje fizike apo mendore të veçantë, ose që lidhen me aspekte të gjinisë, besimit fetar ose praktikave kulturore, ose që janë pjesë e një grupi kulturor etnik ose vijnë nga një situatë migratore;

g) të ngrenë mekanizma efikasë për parandalimin, trajtimin brenda shkollës dhe raportimin tek autoritetet përgjegjëse të situatave të dhunës, duke përfshirë edhe ato ndërmjet vetë fëmijës brenda shkollës (bulizmi);

gj) të parashikojnë dhe zbatojnë sanksione të përshtatshme për personelin arsimor, në rastet kur ai lejon, nxit, toleron ose nuk raporton veprime të dhunshme ose ngacmimi të fëmijës në institucionet e edukimit, sipas këtij ligji.

h) të marrin masa për identifikimin e fëmijës në rrezik për të braktisur shkollën ose të atij që e ka braktisur atë, duke koordinuar veprimet me autoritetet e njësisë së vetëqeverisjes vendore, me qëllim mbajtjen ose kthimin e tij në shkollë.

4. Në rastet kur identifikohen fëmijë që nuk frekuentojnë arsimin e detyrueshëm, për shkak të mosregjistrimit në zyrat e gjendjes civile ose arsye të tjera, punonjësi i njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit, pranë pushtetit vendor merr masa të menjëhershme për regjistrimin të fëmijës në shkollë, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Gjatë procesit mësimor e edukativ fëmija trajtohet me dinjitet nga mësuesit dhe personeli, si dhe informohet për të drejtat e tij dhe mjetet e ushtrimit të tyre, sipas këtij ligji. Ndëshkimi trupor i fëmijës si dhe çdo formë tjetër e dhunës gjatë procesit të edukimit janë të ndaluara.

6. Fëmija ka të drejtë të ankohet ndaj vlerësimeve të dijeve të tij, sipas kritereve të parashikuara në legjislacionin në fuqi për arsimin parauniversitar.

Neni 30¹¹, përcakton se:

“1. Prindi ose kujdestari ka detyrimin t’i sigurojë fëmijës mirëqenien emocionale, fizike, sociale e materiale, duke u kujdesur për të dhe duke marrë masat e nevojshme për ushtrimin e të gjitha të drejtave të parashikuara në këtë ligj.

2. Në rast se prindi ose kujdestari, pavarësisht vullnetit, nuk arrin përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, njësia e mbrojtjes së fëmijës merr masa për të ndihmuar prindin në realizimin e detyrimeve ndaj fëmijës. Në rast se edhe pas ndihmës së dhënë rezulton se qëndrimi i mëtejshëm i fëmijës me prindin nuk është në interesin më të lartë të fëmijës, njësia e mbrojtjes së fëmijës merr masa për largimin e përkohshëm të fëmijës nga prindi dhe e vendos fëmijën në kujdes të përkohshëm alternativ, sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Familjes dhe në këtë ligj.”

Neni 32¹², parashikon se:

“1. Fëmija me aftësi të kufizuar gëzon të gjitha të drejtat e parashikuara në këtë ligj në mënyrë të plotë dhe të barabartë me fëmijët e tjerë.

2. Fëmija me aftësi të kufizuar gëzon të drejtën për të përfutur nga shërbimet shëndetësore, sociale, edukative, si dhe çdo shërbim tjetër, sipas nevojave, të përcaktuara nga strukturat përgjegjëse të vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Autoritetet përgjegjëse marrin masa që këto shërbime të ofrohen sa më pranë fëmijës dhe falas sa herë të jetë e mundur dhe duke pasur parasysh gjendjen ekonomike të prindit ose kujdestarit.

3. Prindi ose kujdestari ka detyrimin të ndjekë procedurat e detyrueshme, sipas këtij ligji, për t’i siguruar fëmijës aksesin në të gjitha shërbimet nga të cilat përfiton sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë

¹¹ Ushtrimi i kujdesit prindëror

¹² Fëmija me aftësi të kufizuar

qëllim, prindi ose kujdestari asistohet nga strukturat e mbrojtjes së fëmijëve sipas nevojës.

4. Fëmijës me aftësi të kufizuara mund t'i ofrohet shërbimi edukativ, shëndetësor apo rehabilitues, në përputhje me nevojat specifike, në një njësi të qeverisjes vendore të ndryshme nga ajo ku jeton dhe që përmbush kriteret për këtë qëllim. Shpenzimet, në këtë rast, mbulohen nga buxheti i të dyja njësive të qeverisjes vendore. Rregullat dhe procedurat për mbulimin e këtyre shpenzimeve përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet sociale, ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe ministrit përgjegjës për arsimin.

5. Autoritetet përgjegjëse, sipas këtij ligji, eliminojnë të gjitha barrierat infrastrukturore, sociale, mjedisore, institucionale dhe ligjore në fushat e arsimit, punësimit dhe arsimit profesional, kujdesit shëndetësor, rehabilitimit, aktiviteteve kulturore, argëtuese dhe sportive, që fëmijët me aftësi të kufizuara të ushtrojnë të drejtat e parashikuara në këtë ligj.

6. Autoritetet përgjegjëse garantojnë përshtatjen e arsyeshme rast pas rasti.

7. Autoritetet përgjegjëse garantojnë pjesëmarrjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha nivelet e politikëbërjes dhe legjislacionit përmes informacionit të përshtatur, sipas llojit të aftësisë së kufizuar, moshës dhe aftësisë së fëmijët për të kuptuar.”

Në zbatim të ligjit për arsimin parauniversitar, Ministria e Arsimit dhe Sportit me Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020, ka miratuar Rregulloren për Funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare.

Në Rregulloren e sipërcituar parashikohet si vijon: “**ARSIMIMI I FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA**”

Neni 80 - Ngritja e komisionit në ZVA dhe detyra të tij

1.ZVA-ja ngre komisionin multidisiplinar të përbërë nga një mjek pediatër (kur është e mundur, mjek pediatër zhvillimi), një psikolog, një punonjës social, një mësues (kur është e mundur, mësues i kualifikuar për arsimin e specializuar) dhe drejtuesi i Njesisë së Shërbimit Psiko-Social.

...

3. Komisioni, me kërkesën e personit që ushtron përgjegjësinë prindërore të fëmijës ose të drejtorit të IA-së, ku fëmija është regjistruar, vlerëson nevojat arsimore të fëmijës dhe ecurinë e tij. “

Neni 82 - Mësuesi ndihmës në institucionin arsimor të zakonshëm.

“Për fëmijët me aftësi të kufizuara në të IA-të publike caktohet mësues ndihmës. Disa nga detyrat e mësuesit ndihmës janë:

- a) të japë ndihmesën e tij për zhvillimin e plotë të potencialit intelektual e fizik të nxënësve me AK;
- b) të bashkëpunojë me mësuesin ose mësuesit lëndorë, mësuesin kujdestar dhe psikologun/punonjës social për gjithëpërfshirjen e nxënësve me AK në IA-të e zakonshme;
- c) të asistojë nxënësin me AK sipas nevojave gjatë procesit mësimor, brenda dhe jashtë klase, për të bërë të mundur pjesëmarrjen e tij sa më të plotë në veprimtaritë shkollore:

ç) të punojë me nxënësit me AK krahas mësuesit në të gjitha orët mësimore vjetore apo në një pjesë të tyre, gjithashtu jashtë klasës, me nxënësit të veçantë me AK ose me grupe të vogla, duke parapëlqyer grupimet e klasave I-III, IV-V dhe VII-X;

d) të hartojë, në bashkëpunim me mësuesin e nxënësit me AK/mësuesit lëndorë dhe personin që ushtron përgjegjësinë prindërore, dhe të zbatojë programin edukativ individual (PEI) të nxënësit, të miratuar nga komisioni i IA-së për fëmijët me AK.”

KREU XV PERSONAT QË USHTROJNË PËRGJEGJËSINË PRINDËRORE

Neni 88 - Të drejtat dhe detyrat e personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore

“1. Në sistemin arsimor parauniversitar garantohet:

a) e drejta e personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore dhe e përfaqësuesve të tyre ligjorë për të shprehur pikëpamjet e tyre për cilësinë e shërbimit arsimor dhe për t'u dëgjuar për këto pikëpamje:

b) e drejta e organizimit të personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore për të mbrojtur të drejtat e tyre, si dhe për të dhënë ndihmesë në mbarëvajtjen e IA-së.

2. Personi që ushtron përgjegjësinë prindërore ka të drejtë të informohet nga IA-ja për:

a) legjislacionin arsimor në fuqi;

b) kurrikulën që institucioni i ofron fëmijës së tij;

c) rregulloren e brendshme të institucionit;

ç) kushtet e sigurisë, të shëndetit dhe të mjedisit të institucionit dhe të kërkojë përmbushjen e tyre sipas standardeve të përcaktuara nga legjislacioni shqiptar;

d) veprimtarinë e fëmijës së tij në institucion dhe të japë pëlqim për veprimtaritë plotësuese e jashtëshkollore dhe ekskursionet që organizon shkolla; dh) drejtimit kryesorë të veprimtarisë së IA-së dhe arritjet e institucionit në krahasim me institucione të ngjashme.

e) të drejtat dhe detyrimet e personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore ndaj IA-së:

ë) masat disiplinore për nxënësit;

f) procedurat e ankimit;

g) procedurat e zhdëmtimeve.

3. Personi që ushtron përgjegjësinë prindërore ka të drejtë të propozojë përmirësime shërbimit arsimor, në nivel klase ose IA-je.

4. Personi që ushtron përgjegjësinë prindërore ka për detyrë:

a) të kujdeset që fëmija i tij të ndjekë rregullisht IA-në dhe të mësojë rregullisht;

b) të njoftojë mësuesin kujdestar për ndryshime të shëndetit dhe të sjelljes së fëmijës së tij.

c) të marrë pjesë në takimet për çështje që kanë të bëjnë me fëmijën e tij;

ç) të njoftojë mësuesin kujdestar në rastet kur fëmija i tij mungon dhe t'i arsyetojë këto mungesa;

d) të marrë pjesë në takime që zhvillohen me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore;

dh) të kontribuojë në mbarëvajtjen e institucionit.

Në respektim të sa më sipër parashikuar, si dhe bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, që në klasën përgatitore, që prej vitit 2018, nxënësi A. H është

ndjekur rregullisht me mësuese ndihmëse, me orar të përcaktuar dhe ka punuar me plan edukativ individual/ PEI.

Nga këqyrja e dokumentacionit, deklarimeve të palëve dhe kronologjia e ngjarjeve dhe fakteve rezulton se:

Nxënësi është vlerësuar nga Komisionet Multidisiplinare që prej shtatorit 2019, e çdo fillim viti shkollor, ka marrë numrin maksimal të orëve nga mësueset ndihmëse, ka punuar me PEI dhe ka realizuar objektivat e caktuara.

Komisioni Multidisiplinar, i ngritur pranë ZVAP Tiranë, ka kryer procesin e vlerësimit të nevojave arsimore në vijimësi për nxënësin A. H, me kërkesë të shkollës 9-vjeçare “4 Dëshmorët”, Tiranë, ku nxënësi është i regjistruar.

Nxënësi është paraqitur pranë Komisionit dhe është vlerësuar në prani të prindit, psikologut të IA, dhe mësueses ndihmëse, për çdo vit shkollor.

Gjatë procesit të vlerësimit, Komisioni ka dhënë rekomandimet përkatëse, ka përcaktuar orët mësimore ku nxënësi do të asistohet me mësues ndihmës në përputhje me specifikat e diagnozës, ecurinë e fëmijës, nevojat e vlerësuara, mundësinë për të nxitur fëmijën drejt pavarësisë dhe ka dhënë udhëzimet përkatëse për hartimin e PEI.

Nga ana e Komisionit është vlerësuar një ecuri e mirë e nxënësit dhe nuk janë vlerësuar vështirësi lidhur me frekuentimin apo sjellje refuzuese të fëmijës ndaj mjedisit të Shkollës.

ZVAP Tiranë i ka përcjellë zyrtarisht Shkollës, rekomandimet e Komisionit çdo vit shkollor në përfundim të çdo faze vlerësimi.

Nga verifikimi i dokumentacionit dhe procedurave të ndjekura nga Komisioni, rezulton se nxënësi në fjalë është ndjekur me mësues ndihmës që nga klasa e parë dhe vijon të mbështetet edhe për vitin shkollor 2024-2025, me tre orë mësimore në ditë, në përputhje me vendimin e Komisionit Multidisiplinar të ZVAP Tiranë, duke përfutur maksimumin e këtij shërbimi, bazuar në përcaktimet e akteve nënligjore në fuqi, përkatësisht si më poshtë citohet:

- Për vitin shkollor 2018-2019 është rekomanduar 11 orë mësimore/javë;
- Për vitin shkollor 2019-2020 është rekomanduar 11 orë mësimore/javë;
- Për vitin shkollor 2020-2021 është rekomanduar 11 orë mësimore/javë;
- Për vitin shkollor 2021-2022 është rekomanduar 11 orë mësimore/javë;
- Për vitin shkollor 2022-2023 është rekomanduar 11 orë mësimore/javë;
- Për vitin shkollor 2023-2024 është rekomanduar 15 orë mësimore/javë;
- Për vitin shkollor 2024-2025 është rekomanduar 15 orë mësimore/javë.

Mësueset ndihmëse, të kërkuara zyrtarisht nga Drejtoria e Shkollës, që kanë punuar me nxënësin A. H, duke filluar nga muaji shkurt 2018 e në vijim, janë dërguar nga Drejtoria Arsimore Rajinale

e Zyra Vendore Arsimore, bazuar në vendimet e Portalit “Mësues për Shqipërinë”, si dhe në aktet ligjore e nënligjore të kohës dhe kanë zbatuar kontratat respektive:

Viti shkollor 2018-2019 (klasa I)

- A. S, me vendim emërimi nr. 33, kontratë e përkohshme pune, datë 17.09.2018, deri më datë 13.06.2019, profili – punë sociale.

Viti shkollor 2019-2020 (klasa II)

- Xh. D, me vendim emërimi nr. 59, kontratë provizore, datë 20.09.2019, deri më datë 17.06.2020, profili – gjuhë-letërsi.

Viti shkollor 2020-2021 (klasa III)

- D. V, me vendim emërimi nr. 113, datë 27.09.2021, vend vakant, profili arsim special, mësuese ndihmëse, dhënë dorëheqjen më datë 11.10.2021, për arsye personale.
- A. S, me vendim emërimi nr. 84, kontratë e përkohshme pune, datë 24.09.2020, deri më datë 15.06.2021, Vendim nr. 96, ndërprerje e kontratës provizore të punës. Profili – gjeografi.

Viti shkollor 2021-2022 (klasa IV)

- A. S, me vendim emërimi, kontratë e përkohshme pune nr. 116, datë 14.10.2021, deri më datë 17.06.2022. vendim ndërprerje e kontratës së punës, profili -gjeografi.

Viti shkollor 2022-2023 (klasa V)

- A. S, me vendim emërimi, kontratë e përkohshme pune nr. 148, datë 27.09.2022 (periudhë prove) deri më datë 30.12.2022. Vendim nr. 156, përfundim i kontratës e mujore të provës.
- A. S, me vendim emërimi nr. 154, kontratë e përkohshme pune, datë 30.12.2022 deri më datë 15.06.2023. Vendim nr. 162, përfundim i kontratës provizore të punës.

Viti shkollor 2023-2024 (klasa VI)

- M. M, me vendimin nr. 182, kontratë pune, periudhë prove deri më datë 12.01.2024, me vendimin nr. 197, kontratë pune, emërim definitive, profili arsim special.

Viti shkollor 2024-2025

- P. K, me vendimin nr. 236, datë 16.10.2024, kontratë provizore pune deri më datë 16.06.2025, me vendimin nr. 12, për ndërprerje të kontratës provizore të punës.

Mësueset me kontrata të përkohshme nuk kanë marrë emërim definitiv për shkak se nuk kanë qenë të arsimit special. Mësuesja M. M, është mësuese e emëruar me kontratë të përhershme pasi është e profilizuar në arsimin special.

Gjatë procesit të rivlerësimit të nevojave arsimore të nxënësve me AK, në periudhën Maj-Qershor 2025, rezulton se prindi nuk ka paraqitur nxënësin pranë Komisionit, për rivlerësimin e nevojave arsimore të fëmijës dhe përfitimin e shërbimeve mbështetëse pranë Shkollës për vitin e ardhshëm shkollor.

Nga informacioni i përcjellë nga Shkolla rezulton se nxënësi ka frekuentuar Shkollën rregullisht me kohë të pjesshme, i shoqëruar nga mësuesi ndihmës 3 (tre) orë mësimi në ditë, deri më datë 24.02.2025. Pas kësaj date nxënësi nuk ka frekuentuar Shkollën dhe arsyeja që prindi ka paraqitur ka qenë se, fëmija refuzon të frekuentojë Shkollën.

Referuar dokumentimit të komunikimeve dhe vëzhgimeve të kryera nga institucioni arsimor dhe shërbimi psiko-social, është konstatuar një mospërputhje mes pretendimeve të ngritura nga prindi dhe sjelljes së fëmijës në ambientet e Shkollës.

Kështu, Komisioneri vëren se, nga ana e Shkollës (kundër së cilës dhe ka adresuar ankesën) janë marrë të gjitha masat për shqyrtimin në kohë dhe me seriozitet të të gjitha pretendimeve të prindit të fëmijës A. H, dhe se ato janë shqyrtuar duke pasur në konsideratë interesin më të artë të fëmijës, lidhur me mundësimin për ndjekje efektive të procesit mësimor nga ana e nxënësit.

Konkretisht:

I është sugjeruar prindit shoqërimi i fëmijës gjatë zhvillimit të orëve mësimore, me qëllim rritjen e sigurisë dhe përfshirjes së tij në procesin edukativ. Gjithashtu, prindit i është dhënë mundësia të shprehë preferencën për përzgjedhjen e mësueses ndihmëse, me qëllim krijimin e një marrëdhënieje sa më të mirë bashkëpunimi dhe besimi me fëmijën.

Po ashtu, i është sugjeruar mundësia e asistencës në kushte shtëpie nga ana e mësueses ndihmëse, në rastet kur ndjekja e procesit mësimor në ambientet e Shkollës është refuzuar.

Për çdo kërkesë të paraqitur nga prindi, Shërbimi Psiko-Social i Shkollës ka ofruar mbështetje të vazhdueshme dhe të menjëhershme, në funksion të mirëqenies dhe përfshirjes së nxënësit në sistemin arsimor.

Megjithatë, të gjitha këto mundësi të ofruara nga Shkolla janë refuzuar kategorikisht nga prindi, duke mos e dërguar fëmijën në Shkollë.

Rezulton se, në njoftimet e psikologes për mbledhjen e Komisionit AK, në Shkollë, z. H nuk është paraqitur rregullisht. Ka shmangur mbledhje që janë shumë të rëndësishme për miratimin dhe dakordësinë e tij për përmbajtjen e planit PEI, duke mos i dhënë mundësinë Komisionit të shqyrtojë pretendimet e prindit për të bërë ndryshimet e kërkuara.

Psikologjia e Shkollës ka ofruar të gjithë mbështetjen e nevojshme profesionale për ndjekjen e planit PEI, me synimin për t'i garantuar fëmijës një arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës.

Pavarësisht se z. A. H ka refuzuar të firmosë dhe të jetë pjesë aktive në procesin e PEI, Shkolla, në bashkëpunim me psikologjen, mësuesin mbështetës dhe Komisionin e AK, ka vazhduar punën me fëmijën, duke i garantuar atij pjesëmarrje të rregullt në procesin mësimor dhe vënie në dispozicion të mësueses ndihmëse.

Gjithashtu, prindit i është dhënë mundësia të shprehë preferencën për përzgjedhjen e mësueses ndihmëse, me qëllim krijimin e një marrëdhënieje sa më të mirë bashkëpunimi dhe besimi me fëmijën.

Nga ana tjetër, referuar dokumentacionit të shqyrtuar dhe legjislacionit sipërcituar, rezulton se Shkolla dhe ZVAP Tiranë, kanë shqyrtuar çdo pretendim të z. H kundrejt Shkollës, bazuar në parashikimet e Urdhrit nr. 31, datë 28.01.2020, Rregullore për Funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare.

Referuar procesverbalëve të takimeve e mbledhjeve të ndryshme, relacioneve të Shërbimit Psiko-Social të Shkollës, relacioneve të Grupit Ndërsektorial e akteve të tjera, të depozituara lidhur me shqyrtimin e sa më sipër, rezulton se, pasi kanë shqyrtuar provat dhe faktet në dispozicion, nuk kanë konstatuar ndonjë shkelje apo parregullsi për sa është pretenduar, qoftë lidhur me pretendimet për mësueset ndihmëse në kuadër të ushtrimit të detyrës së tyre, lidhur me procesin e mësimdhënies, qoftë për pretendimet e tjera të shprehura verbalisht të padokumentuara lidhur me arsyet e mosfrekuentimit të procesit mësimor nga fëmija.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, shkolla 9-vjeçare “4 Dëshmorët” Tiranë dhe ZVAP Tiranë kanë zbatuar legjislacionin e sipërcituar, i detyrueshëm për institucionet arsimore, duke shqyrtuar dhe trajtuar rastin sipas fakteve dhe provave të grumbulluara nga palët, nëpërmjet psikologut të shkollës, Komisionit Multidisiplinar, raportimit e referimit të rastit tek NJMF, dhe se nxënësi A. H, nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë e të pafavorshëm nga ana e Shkollës. Prindit i janë ofruar të gjitha mundësitë për të zgjedhur mënyrën e përshtatshme sipas kushteve të tij, (qoftë edhe nëpërmjet asistimit të nxënësit në banesë nga mësuesi ndihmës), mundësi të cilat nuk i ka konsideruar, duke bërë që Shkolla të referojë në vijim rastin tek NJMF, pranë Njesisë Administrative nr. 8, Tiranë.

Shkolla, pasi ka zhvilluar të gjitha takimet informuese dhe i ka bërë me dije prindit detyrimin ligjor për arsimimin e fëmijës së tij, ka referuar rastin pranë Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve (PMF) në njësinë administrative përkatëse. Pas referimit, PMF, ka menaxhuar rastin, duke kryer të gjitha vlerësimet e nevojshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Referuar dokumentacionit të sipërcituar, Shkolla, ka marrë të gjitha masat për informimin në vazhdimësi të prindit A. H, lidhur me frekuentimin e procesit mësimor nga ana e fëmijës së tij. Gjithashtu, Shkolla, në zbatim të përgjegjësisë ligjore, ka informuar dhe ka kërkuar ndihmë dhe nga Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve, të Njesisë Administrative nr. 8, lidhur me mosfrekuentimin e procesit mësimor nga ana e fëmijës së z. H.

Komisioneri vlerëson se, z. H në cilësinë si prindi i fëmijës, duke pasur parasysh interesin më të lartë të tij, për të ndjekur procesin mësimor-edukativ, duhet të kishte marrë të gjitha masat e nevojshme për t’u impenjuar lidhur me dërgimin e fëmijës në Shkollë apo të zgjidhte njërën nga alternativat e propozura nga Shkolla në mënyrë që fëmija të frekuentonte efektivisht mësimin.

Në përfundim, lidhur me kërkimin e z. H pra KMD-së, se: *“Nuk kërkoj ndërrimin e mësueses ndihmëse dhe psikologes së Shkollës por, të shikohen problematikat, pasi këto i izolojnë dhe nuk i japin zgjidhje, pasi ndoshta mund të kenë ngarkesë politike (mendoj unë si prind)”*, Komisioneri gjatë analizës së informacionit dhe provave të sipërcituara, konstatoi se:

- Nga ana e Shkollës, janë ndjekur të gjithë procedurat dhe hapat, në mbështetje të akteve ligjore/nënligjore, për shqyrtimin e pretendimeve të z. H.
- Janë bërë përpjekje e hapa të vazhdueshëm nga ana e të gjitha strukturave a personave përgjegjes, në raport me komunikimin me z. H për frekuentimin e procesit mësimor nga ana

e fëmijës së tij, A. H, si dhe detyrimet e tij si kujdestar ligjor e person përgjegjës për fëmijën, për sa më sipër, detyrime që burojnë nga legjislacioni në fuqi.

- Prindi është bërë pengesë reale duke mos bashkëpunuar me strukturat përkatëse të Shkollës dhe institucioneve të tjera, duke mos i dhënë përparësi interesit më të lartë të fëmijës, si dhe duke i mohuar atij të drejtën (njëherësh dhe detyrimin) për frekuentim të procesit mësimor dhe socializim me shokët e shoqet e klasës.
- Rezulton se nxënësi në fjalë është ndjekur me mësues ndihmës që nga klasa e parë dhe për vitin shkollor 2024-2025, me tre orë mësimore në ditë, në përputhje me vendimin e Komisionit Multidisiplinar të ZVAP Tiranë, duke përfituar maksimumin e këtij shërbimi, bazuar në përcaktimet e akteve nënligjore në fuqi.
- Mësimi me nxënësin është bërë bazuar në PEI, të individualizuara e dedikuara A, sipas vlerësimit të Komisionit Multidisiplinar.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1 të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si nga ligjet në fuqi”*.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7/1 të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se shkolla 9-vjeçare “4 Dëshmorët”, Tiranë, ka zbatuar legjislacionin e sipërcituar, i detyrueshëm për institucionet arsimore dhe se nuk ka ndërmarrë veprime që kanë ekspozuar fëmijën e subjektit ankues ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje të paligjshme nga ana e këtij institucioni, për shkakun e pretenduar nga ankuesi dhe për rrjedhojë nuk provohet se shkolla 9-vjeçare “4 Dëshmorët”, Tiranë, ka shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

- ***Lidhur me mungesën e oficerit të sigurisë në Shkollë, të pretenduar nga z. H, Komisioneri evidenton se:***

Së pari, caktimi i këtij punonjisi sigurie nuk është në kompetencën e Shkollës, por të MAS, dhe *së dyti*, në referencë të Vendimit nr. 600, datë 09.10.2018, të Këshillit të Ministrave, ku parashikohet

që, oficerë sigurie caktohen në shkollat me mbi 700 nxënës, shkolla 9-vjeçare “4 Dëshmorët”, Tiranë, nuk ka përfituar oficer sigurie, referuar numrit më të vogël të nxënësve.

Në prill të vitit 2025, me ndryshimin e pësuar në legjislacionin përkatës, ku përcaktohet se: *“Institucionet e arsimit bazë ose shkollat e bashkuara që kanë mbi 350 nxënës, të kenë një oficer sigurie”*, shkolla 9-vjeçare “4 Dëshmorët”, përmbush kriterin e numrit të mësipërm të nxënësve dhe ka përfituar nga vendosja e një oficeri sigurie, për vitin shkollor 2025-2026.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të nxënësit A. H nga ana e Shkollës 9-vjeçare “4 Dëshmorët”, Tiranë.
2. Rekomandohet që prindi të marrë masat e menjëhershme për frekuentimin e procesit mësimor nga ana e fëmijës dhe të bashkëpunojë me strukturat përkatëse në interesin më të lartë të fëmijës së tij.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA